



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

OPINION

MBI

KANDIDATIN QË KA APLIKUAR PËR T'U KOMANDUAR SI PEDAGOG I BRENDSHËM, NË DEPARTAMENTIN E FORMIMIT FILLESTAR, TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 264 dhe 265 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në nenet 53 e 54 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, mbi kërkesën e Shkollës së Magjistraturës, me Vendimin Nr. 99 datë 26.02.2020, shpalli hapjen e procedurës për paraqitjen e kërkesës nga kandidaturat që vijnë nga radhët e gjyqtarëve, për t’u komanduar, me pëlqimin e tyre, në pozicionin e pedagogut të brendshëm, në Departamentin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës.

Me Vendimin nr.142 datë 22.04.2020, Këshilli shpalli rifillimin e procedurave administrative të pezulluara për shkak të parandalimit të përhapjes së Covid-19 duke zgatur afatin e kandidimit me një javë, në procedurën e komandimit në Shkollën e Magjistraturës, për pozicionin e shpallur me vendimin nr. 99, datë 26.02.2020.

Vendimi i fundit, si më lart i Këshillit të Lartë Gjyqësor, është shpallur në faqen zyrtare të internetit më datë 22.04.2020, ndërsa afati i paraqitjes së kërkesave për komandim në vendin vakant është përcaktuar1 (një) javë nga dita e shpalljes së vendimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, afat ky që përfundonte më datë 29.04.2020.

Brenda afatit të caktuar për paraqitjen e kërkesave për komandim, me datë 29.04.2020, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor ka paraqitur kërkesë znj. Teuta Hoxha, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në nenin 54, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, lidhur me procedurën e komandimit, ndër të tjera parashikohet se: “Këshilli, brenda dy javëve pas afatit të aplikimit, përgatit një opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ose prokurorisë ku kandidati ushtron funksionin. Opinioni për çdo kandidat publikohet në faqen zyrtare të Këshillit. Kandidati, komandimi i të cilit nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ose prokurorisë, përjashtohet nga komandimi. Këshilli, brenda dy javëve pas afatit të kandidimit, i dërgon institucionit në të cilin do të bëhet komandimi emrat e kandidatëve që plotësojnë kriteret e pozicionit përkatës...”

Ndërsa në vendimin Nr. 99 datë 26.02.2020 të Këshillit “Për hapjen e procedurës së komandimit në Shkollën e Magjistraturës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve” ndër të tjera citohet se: “Brenda dy javëve pas përfundimit të afatit të aplikimit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin. Projekt-opinionin për çdo kandidat shqyrtohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor jo më vonë se një javë pas njoftimit të Kryetarit të Këshillit për përgatitjen e tyre. Opinione të miratuara nga Këshilli publikohen në faqen zyrtare të tij. Këshilli mund të vendosë përjashtimin nga komandimi të kandidatit kur komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku ai ushtron funksionin ose kur verifikohet që kandidati nuk plotëson ndonjë prej kushteve të tjera ose kriteret e komandimit, me përjashtim të atij të mësimdhënies.

Në respektim të nenit 54 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe të vendimit Nr. 99 datë 26.02.2020 të Këshillit, lidhur me vlerësimin nëse komandimi është në përputhje me interesat e larta të gjykatës ku kandidatja ushtron funksionin, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës çmon se, në rastin konkret, komandimi i kësaj gjyqtareje nuk vjen ndesh me interesat e larta të gjykatës ku ajo ushtron funksionin.

Në dhënien e këtij vlerësimi, Komisioni konsideron faktin që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë është gjykata më e madhe në vend dhe në organikën e saj ka 76 gjyqtarë, ku aktualisht funksionin e gjyqtarit e ushtrojnë 62 gjyqtarë. Gjithashtu Këshilli vlerëson dhe ngarkesën e kësaj gjykate, nga ku rezulton se aktualisht Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka në gjykim 10318 çështje dhe mesatarja e çështjeve në gjykim për gjyqtar rezulton të jetë 166.

Në këto kushte, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerëson se komandimi i znj. Hoxha në pozicionin e pedagogut të brendshëm, në Departamentin e Formimit Fillestar, të Shkollës së Magjistraturës, nuk passjell cenim të interesave të larta të kësaj gjykate për sa kohë nuk cenohet funksionaliteti i saj, ndërsa kjo gjykatë, në rrethanat aktuale, pavarësisht ngarkesës, ka mjaftueshëm gjyqtarë për ofrimin e shërbimit gjyqësor. Të njëjtin mendim dhe qëndrim dha për Komisionin dhe kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Bazuar sa më sipër, me qëllim për të vijuar me procedurat e mëtejshme të komandimit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor:

- *Miratimin e opinionit për kandidaten, gjyqtaren Teuta Hoxha.*
- *Publikimin e këtij opinionin në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*